

Në bazë të nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, nenit 12, al. 1 dhe 2, nenit 17 al.1, pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25. al 4, pika b dhe nenit 27, al.1 të Statutit të Kuvendit të komunës së Prizrenit, Kuvendi i komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2008, miratoi këtë

- V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit - Zona e Parë e Mbrojtjes

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i PRRU-së për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit - **Zona e Parë e Mbrojtjes**, e cila ofrohet si donacion nga OJQ-ja Suedeze CHWB "Trashëgimia Kulturore pa Kufij" (bartës i hartimit të Planit), e njëjta hartuar në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të Prizrenit.

Pjesë përbërëse e këtij PRRU do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- Zhvillimin e qëllimeve dhe objektivave të zonës historike të Prizrenit;
- Shqyrtimin dhe analizat e zonës së studimit të Prizrenit;
- Vlerësimin e Planit të Konservimit të Prizrenit dhe
- Zbatimin.

Pjesa grafike përmban:

- Paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban për konservim dhe zhvillim të zonës historike të Prizrenit.

Neni 2

Me Planin Rregullues Urban për konservim dhe zhvillim të zonës historike për **Zonën e Parë të Mbrojtjes**, përfshihen pjesët e qytetit të vjetër që i ka të ruajtura lagjet historike që karakterizohen me fizionominë e tyre të veçantë, rrjetin e rrugëve, sheshet, komplekset me rëndësi kulturore dhe historike dhe shumë objekte sakrale dhe profane me interes të lartë arkitektonik si pjesë themelore të trashëgimisë historike dhe kulturore të Prizrenit, që përfshin një sipërfaqe prej $S= 42.697$ ha e definuar sipas Planit Zhvillimor Urban të Prizrenit.

Neni 3

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi, do të planifikohet një zhvillim bashkëkohor i cilësisë mjedisore të zonës historike të Prizrenit, në mbrojtjen e vlerave historike, arkitektonike dhe funksionale.

Neni 4

Plani Rregullues Urban hartohet për periudhën kohore më së paku 5 (pesë) vjeçare.

Neni 5

Ky Vendim, bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1, alineja 2 të këtij Vendimi, do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të Prizrenit.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit dhe e Planifikimit Hapësinor dhe Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore.


Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe i njëjti do të shpallet në "Kumtar".

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Nr. 01/011-6604

Prizren, më 18 dhjetor 2008



Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu